



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 shtator 2012
Nr. ref.RK 299 /12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 88/11

Parashtrues

Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës

Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Supreme nr. AP 306/2011, të 6 prillit 2011

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës, e përfaqësuar nga Pastori Femi Cakolli.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme nr. 306/2011, të 6 prillit 2011, i cili iu dorëzua më 7 qershor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me interpretimin e Kushtetutës lidhur me regjistrimin e popullsisë dhe aktet ligjore, zyrtare dhe teknike që e përcollën procesin e regjistrimit të vitit 2011.
4. Parashtruesja pohon që të kërkosh nga qytetarët ta deklarojnë përkatësinë e tyre fetare në regjistrimin e vitit 2011 është shkelje e nenit 8 të Kushtetutës, i cili përcakton: *Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.*

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesja e parashtrroi kërkesën në Gjykatë më 29 qershor 2011.
7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 19 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 31 janar 2011, parashtruesja u ankua në Entin Statistikor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ESK) lidhur me regjistrimin e popullsisë për shkak të brengave se anëtarët e parashtrueses nuk ishin në gjendje ta shprehnin lirisht përcaktimin e tyre fetar në procesin e regjistrimit të përgjithshëm për shkak se ata ende jetojnë në familjet myslimane apo katolike dhe si rrjedhojë këta anëtarë *“statistikisht nuk do të ekzistojnë fare”*.
10. Parashtruesja iu ankua Avokatit të Popullit për të njëjtën çështje më 22 shkurt 2011 dhe 7 mars 2011.
11. Më 24 mars 2011, Avokati i Popullit iu përgjigj parashtrueses duke ia rikujtuar që *“neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, i autorizon individët të ngrenë në Gjykatë Kushtetuese shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë”*. Përveç kësaj, Avokati i Popullit theksoi se *“kërkesa për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (...) është e papranueshme, për shkak se jeni në shfrytëzim të mjeteve juridike”*.

12. Më 31 mars 2011, parashtruesja ushtroi padi në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër ESK-së për shkak të heshtjes administrative lidhur me ankesën e saj, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe injorim ndaj një bashkësie fetare legale në Kosovë.
13. Duket që parashtruesja e ka ushtruar atë padi pa e respektuar nenin 29 të Ligjit Nr. 03-L-202 për konfliktet administrative (në tekstin e mëtejme: LKA), që do të thotë pa e ushtruar kërkesën e dytë në ESK dhe pa pritur afatin prej shtatë ditësh, si kriter i domosdoshëm ligjor për të ushtruar kërkesë në Gjykatën Supreme.
14. Megjithatë, parashtruesja kërkoi nga Gjykata Supreme që ta ndalonte ESK-në nga publikimi i rezultateve nga pyetja 10 e formularit R3 dhe kërkoi komente lidhur me Ligjin për regjistrimin e popullsisë.
15. Më 6 prill 2011, Gjykata Supreme nxori vendim në procedurën nr. 306/2011 lidhu me dy paditë e parashtruara nga parashtruesja (nr. 306/2011 dhe A. nr. 315/2011) për shkak se ESK-ja ende nuk kishte vendosur lidhur me kërkesën e saj.
16. Gjykata Supreme konkludoi që “kërkesat janë të parakohshme” dhe, si rrjedhojë, i refuzoi kërkesat. Gjykata Supreme arsyetoi se “sipas dispozitave të nenit 29, paragrafit 2, të LKA-së, pas skadimit të afatit prej 30 ditësh, paditësja është dashur ta përsërisë kërkesën e vet dhe të kërkojë nga ESK-ja të vendosë lidhur me kërkesën e saj dhe gjithashtu të presë edhe shtatë ditë të tjera nga paraqitja e kërkesës së përsëritur. Nëse pas kalimit të këtij afati ESK-ja nuk do të vendoste lidhur me kërkesën, paditësja do të mund të ushtronte kërkesë për fillim të konfliktit administrativ.
17. Së fundi, *“me që paditësja nuk i është drejtuar Entit të Statistikave të Kosovës me kërkesë të përsëritur, Gjykata Supreme, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 34 par. 1 pika 1 lidhur me nenin 29 par 2 të LKA, gjeti se në këtë çështje administrative nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ për shkak të heshtjes së administratës.”*
18. Përveç kësaj, në këshillën juridike të vendimit të Gjykatës Supreme thuhet: *“Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, e tilla i paraqitet Gjykatës Supreme të Kosovës, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes së tij.”*
19. Parashtruesja nuk tregon që ankesa është ushtruar kundër këtij aktvendimi brenda afatit të përcaktuar.
20. Më 10 qershor 2011, Avokati i Popullit e njoftoi Pastorin Femi Cakolli se hetimi lidhur me këtë ankesë ishte ndërprerë. Shkresës i ishte bashkëngjitur “vendimi mbi largimin e çështjes nga lista”, ku shpreheshin shkurtimisht veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën dhe arsyetimi i vendimit.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesja

21. Parashtruesja pohon që miratimi nga ESK-ja i pyetjes 10 të formularit R3 të regjistrimit të vitit 2011, e cila kërkonte përgjigje në pyetjen “Cili është besimi juaj fetar?”, e pasuar nga gjashtë mundësi: “(1) Islam, (2) Ortodoks, (3) Katolik, (4) Tjetër (shëno), (5) Asnjë besim fetar, apo (6) Preferoj të mos përgjigjem” (...) është “shkelje e Kushtetutës dhe Ligjit për liritë fetare dhe shkelje e të drejtave të njeriut dhe e ndërgjegjes së besimit të qytetarëve”.
22. Parashtruesja pohon që ESK-ja gjoja ndërhyri në çështje fetare duke kërkuar që qytetarët ta deklarojnë përkatësinë e tyre fetare në procesin e regjistrimit.

Parashtruesja beson që kjo është shkelje e nenit 8 të Kushtetutës, i cili thotë: *Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.*

23. Parashtruesja vëren që Ligji Nr. 03/L-237 për regjistrimin e popullsisë hyri në fuqi në nëntor të vitit 2010 dhe regjistrimi u mbajt prej 1 deri më 15 prill 2011. Parashtruesja mendon që nuk është mbajtur asnjë debat publik për procesin e regjistrimit dhe ligjin për regjistrimin e popullsisë. Përveç kësaj, parashtruesja pohon që formularët e regjistrimit ishin shtypur para shpalljes së ligjit të zbatueshëm për regjistrimin e popullsisë.
24. Në përgjithësi, parashtruesja pretendon me sa vijon:
- 1) Së pari, ESK-ja shkeli nenin 8 të Kushtetutës duke kërkuar që qytetarët ta deklarojnë përkatësinë e tyre fetare;
 - 2) Së dyti, ESK-ja shkeli nenin 5.4 të Ligjit Nr. 02/L-31 për liritë fetare, duke mos e paraqitur bashkësinë ungjillore në formularin F3;
 - 3) Së treti, thuhet që regjistruarit e ESK-së i kanë mbushur në mënyrë të padrejtë formularët e regjistrimit duke shënuar apriori “islam” si përgjigje për përkatësi fetare pa e pyetur paraprakisht individin për këtë çështje;
 - 4) Së katërti, pyetja 10 në formularin F3 nuk ishte neutrale. Qytetarëve është dashur t’u ofrohej mundësia të mos zgjedhin të përgjigjen në këtë pyetje; dhe
 - 5) Së fundi, konkluzioni i Gjykatës Supreme është “i papranueshëm dhe jopraktik”.
25. Në përfundim, parashtruesja kërkon që Gjykata:
- 1) Të vendosë nëse neni 8 i Kushtetutës është shkelur gjatë regjistrimit të popullsisë;
 - 2) Të pengohet ESK-ja nga publikimi i rezultateve nga pyetja 10 në formularin F3 nëse konsiderohet e pavlefshme nga pikëpamja kushtetuese apo në kundërshtim me nenin 5.4 të Ligjit Nr. 02/L-31 për liritë fetare; dhe
 - 3) Të përcaktojë nëse të drejtat e njeriut të protestantëve të Kosovës janë shkelur nga ESK-ja në kundërshtim me nenin 5.4 të Ligjit Nr. 02/L-31 për liritë fetare, duke mos e përfshirë fenë protestante si mundësi në regjistrim.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Kriteret për pranueshmëri janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
27. Paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës e përcaktojnë kornizën e përgjithshme ligjore që kërkohet për pranueshmëri. Ata përcaktojnë:
1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)*
 7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

28. Rregulli i shterimit të të gjitha mjeteve juridike korrespondon me obligimin e gjykatave të rregullta për t'i korigjuar shkeljet e të drejtave themelore që mund të kenë ndodhur në faza të ndryshme të ankesës. Në të vërtetë, sipas nenit 102 (3) të Kushtetutës, "Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit". Prandaj, çdo gjykatë është e obliguar të ofrojë mbrojtje ligjore në rast të shkeljes së Kushtetutës.
29. Në anën tjetër, parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta penguar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korigjuar shkeljen e një të drejte themelore. Prandaj, palët që nuk ndërmarrin ndonjë hap procedural në gjykata të rregullta vetë bartin përgjegjësinë nëse rastet e tyre shpallen të papranueshme, pasi kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për kundërshtim të mëtejme të shkeljes.
30. Prandaj, parashtruesja duhet të tregojë se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
31. Me pak fjalë, parashtruesja duhet t'i ndërmarrë të gjithë hapat që në mënyrë të arsyeshme mund të priten nga ajo për t'i shteruar mjetet juridike vendëse (*D.H. dhe të tjerët kundër Republikës së Çekisë [DHM, nr. 57325/00, GJEDNJ 2007-XII]*).
32. Megjithatë, sa i përket kësaj kërkesë, duket që parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
33. Në të vërtetë, më 6 prill 2011, Gjykata Supreme konkludoi (Vendimi nr. 306/2011) që padia ishte e parakohshme për shkak se parashtruesja nuk e kishte respektuar nenin 29 të Ligjit Nr. 03-L-202 për konfliktet administrative.
34. Neni 29 i LKA-së thotë:
- a. *Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejme prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.*
- b. *Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.*
- c. *Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim.*
35. Përveç kësaj, parashtruesja nuk është ankuar brenda afatit prej 15 ditësh kundër Vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, nr. AP 306/2011, të 6 prillit 2011, pas marrjes së këshillës juridike të vendosur në të njëjtin vendim. Përkundër këshillës që

parashtruesja mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme të Kosovës me ankesë kundër vendimit të saj, ajo nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë ligjore.

36. Gjykata gjithashtu vëren që dyshimi i thjeshtë për perspektivën e çështjes nuk mjafton për ta përjashtuar parashtruesin nga detyrimet e tij për t'u ankuar në organet kompetente (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendim i 7 marsit 1994, Kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f. 80).
37. Në të vërtetë, rregulli i shterimit kërkon që kërkesa duhet të parashtrohet në gjykatat [e rregullta] përkatëse dhe se duhet të shfrytëzohen mjetet e parapara juridike për ta kontestuar vendimin që tashmë është nxjerrë. Kjo normalisht kërkon që ankesat (...) duhet të parashtrohen (...) në pajtim me kriteret zyrtare dhe afatet e përcaktuara në ligjin vendës (po aty, f. 25-27, paragrafët 71-72; shih gjithashtu vendimin e Komisionit të 11 janarit 1961 për pranueshmëri të kërkesës nr. 788/60, Austria kundër Italisë, Vjetari i Konventës, vëllimi 4, f. 170-172); dhe se është dashur të përdoren mjetet procedurale që do të mund ta pengonin shkeljen [e Kushtetutës] (shih Aktgjykimin Barberà, Messegué dhe Jabardo, të 6 dhjetorit 1988, Seria A nr. 146, f. 28-29, paragrafët 58-59, si dhe vendimin e Komisionit të cituar më lart, f. 166-170).
38. Prandaj, nga pikëpamja e gjetjeve të Gjykatës Supreme, kjo kërkesë duhet të konsiderohet e papranueshme pasi nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani